

---

**Ky statut miratohet e nënshkruhet nga ortakët themelues, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, në Tiranë, sot më 06.06.2022**

**STATUT**

**I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AGRO ILIRIA SOLAR"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" – i ndryshuar, themelohet shoqëria "AGRO ILIRIA SOLAR" SHPK, veprimitaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

**Neni 1**

**Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me, Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

**Neni 2**

**Ortakët e shoqërisë**

Ortakët e shoqërisë janë:

- **Agro Iliria Group sh.p.k.,** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar në QKB në datë 19/01/2015, me adresë Rruga Durresit, Sheshi Karl Topia, Kulla nr.3, Kati nr.2 Tiranë me NIPT/NUIS L51320033L.
- **RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN,** shoqëri aksionere regjistruar në QKB në datë 01.07.1996 me adresë BALEZ POSHTE Fshati Balez Poshte, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11 dhe NIPT/NUIS J629042640
- **Ilir Hoxhallari,** shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më datë 24.09.1970, me kartë identiteti me nr. 033902691.
- **Yusuf Gökdemir,** shtetas Shqiptar, lindur në Görele, Turqi (TUR) dhe banues në ELBASAN, Leternoftim ID nr. 035687839 dhe nr. personal I10623216C

---

Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Agro Iliria Solar" SHPK

- 
- **Ermal Koka, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, lindur më 14/09/1986, Leternjoftim ID nr. 036851277 dhe nr. personal I60914053J**

### **Neni 3**

#### **Forma ligjore**

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar", shkurt, "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 5**

#### **Selia**

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Ruga "Ibrahim Rugova", Pallati 40/2/4, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë**.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

### **Neni 6**

#### **Dokumentet e shoqërisë**

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhreve apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
  - a) numrin unik të identifikimit;
  - b) formën ligjore të shoqërisë;
  - c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;

---

Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Agro Iliria Solar" SHPK

- 
- c) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
  - d) vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;

6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen edhe aty.

## Neni 7

### Objekti i veprimtarisë

#### 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaikë, parqet e eres, termocentralet, biomasa etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaikë, eolike, hidrike) te energjisë elektrike, te cilat shfrytezojnë burimet e rinovueshme te energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Perfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin keto organe Qendrore apo Vendore), apo private te cilat mundesojnë zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- Shitia me shumice dhe pakice e energjisë elektrike tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret e energjisë elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa te tjera te energjisë jashte vendit.
- Pervec sa me siper, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektin e mesiperm. Per arritjen e qellimit te mesiperm, Shoqeria mund te kryeje cdo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, finanziar, qiraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqerise.
- Duke perfshire por pa u kufizuar ne linjat elektrike te tensionit te larte dhe te mesem, nenstacione elektrike dhe njesi te tjera te lidhjeve elektrike, rrugeve te aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur me sa me siper, si punime germimi, punime per prishjen dhe punime te tjera te tokes, punime civile, elektrike dhe mekanike te cdo lloji si dhe blerje, shitje, shkembim, import-eksport

---

te pajisjeve, riparim dhe mirembajtje te materialeve dhe pajisjeve dhe te gjithe aktivitetet e lidhura me keto ceshtje, gjithashtu dhe ne fushen e aktiviteve te tregtimit.

- 7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

## Neni 8

### Kapitali themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100,000 (njëqind mijë lekë)**.

- 8.2 Numri i kuotave 5 (pesë)

**Agro Iliria Group sh.p.k.**, me NIPT/NUIS L51320033L pjesëmarrja në përqindje 34 %, numri i kuotave 1, me vlerë kapitali 34000 lekë.

**RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN**, shoqëri aksionere dhe NIPT/NUIS J629042640 pjesëmarrja në përqindje 33%, numri i kuotave 1 me vlerë kapitali 33000 lekë.

**Ilir Hoxhallari**, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më datë 24.09.1970, me kartë identiteti me nr. 033902691 pjesëmarrja në përqindje 11%, numri i kuotave 1 me vlerë kapitali 11.000 lekë.

**Yusuf Gökdemír**, shtetas Shqiptar, lindur në Görele, Turqi (TUR) dhe banues në ELBASAN, Leternjoftim ID nr. 035687839 dhe nr. personal I10623216C pjesëmarrja në përqindje 11%, numri i kuotave 1 me vlerë kapitali 11.000 lekë.

**Ermal Koka**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, lindur më 14/09/1986, Leternjoftim ID nr. 036851277 dhe nr. personal I60914053J pjesëmarrja në përqindje 11%, numri i kuotave 1 me vlerë kapitali 11.000 lekë.

## Neni 9

### Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë, pa nevojën e ndonjë formaliteti nga ana e shoqërisë dhe/ose të drejtën e parablerjes nga ortaku tjetër/ortakët e tjerë.

## Neni 10

### Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

---

Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Agro Iliria Solar" SHPK

- 
- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
  - 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesa të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve te ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

#### **Neni 11**

##### **Asambleja e Ortakëve**

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
  - ndryshimi i dispozitave të statutit,
  - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
  - emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
  - miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
  - miratimi i llogarive vjetore(bilancit),
  - ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,
  - mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.
- 11.3 Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.

- 
- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjera, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

## **Neni 12**

### **Vendimmarrja**

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Prosesverbalit nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

## **Neni 13**

### **Administratori**

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë do të jetë:
- **Ilir Trebicka, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 25.05.1954, me kartë identiteti me nr. 033134069.**

---

Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Agro Iliria Solar" SHPK

- 
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.
  - 13.4 Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
  - 13.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

#### **Neni 14**

##### **Kontrolli financiar**

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

#### **Neni 15**

##### **Viti financiar**

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 16**

##### **Bilanci dhe Dividendët**

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

---

Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Agro Iliria Solar" SHPK



- 16.3. Deri në shlyerjen e investimit fillestare, ortakët bien dakord që në rast se shoqëria do të realizojë një fitim vjetor, nga shpërndarja e dividendëve përkatës do të përfitojnë vetëm ortakët që zotërojnë respektivisht nga 30% të kuotave. Më pas dividendët do tu shpërndahen të gjithë ortakëve të shoqërisë, proporcionalisht me përqindjen e zotërimit të kuotave.

#### Neni 17

##### Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

#### Neni 18

##### Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në dy ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

#### ORTAKËT



RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN

Administratori

Kujtim Hasa

Ilir Hoxhallari

Yusuf Gökdemir

Ermal Koka

Illir Hoxhallari

Yusuf Gökdemir

Ermal Koka

Datë 06.06.2022

**Ky dokument shërben edhe si akt themelimi i shoqërisë "AGRO ILIRIA SOLAR" SHPK**